



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 23.04.2025
Numër Protokolli: 2752/2025

A.nr.344/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-Kryetar, Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi Bajraktari–anëtarë, me Çlirim Zeka–në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.344/2025 të datës 20.02.2025 të parashtruar nga ankuesja J.A., kundër organit të punësimit Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, në çështjen juridike “*Kontestim Konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin dhe 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 23.04.2025 mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.344/2025 e datës 20.02.2025 e parashtruar nga ankuesja J.A.

II. Mbetet në fuqi Njoftimi për kandidatin fitues për pozitën Udhëheqës i Divizionit Transparencës i Njesisë së Burimeve Njerëzore i datës 27.01.2025 i Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve.

A r s y e t i m

Ankuesja J.A. (më tej referuar vetëm ankuesja), më datë 20.02.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 1148/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimin ankimor kundër njoftimit për kandidatin fitues për pozitën Udhëheqës i Divizionit të Transparencës të Njesisë së Burimeve Njerëzore të datës 27.01.2025 të Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve, për shkak të njëanshmërisë nga ana e komisionit të pranimi, ushtrimit të ndikimit ndërhyrjes ndaj një anëtareje të komisionit të pranimit në vlerësimin e esesë, shkeljes së paragrafit 10.3 të nenit 10, paragrafit 3 të nenit 11 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për procedurën e pranimit në shërbimin civil e njëjta dyshon që i është bërë e padrejtë dhe janë shkelur rregullat e rregullores përkatëse nga anëtarët e komisionit konkretisht kryesuesi, dhe se komisioni e ka vlerësuar me pikët maksimale kandidatin fitues

ndërsa mua me pikët minimale, kërkon të anulohet konkursi për pozitën Udhëheqës i Divizionit Transparencës dhe të rishpallet për të njëjtën pozitë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 10.03.2025 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, ndërsa Këshilli më datë 19.03.2025 ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerrë vendimin me numër VK/2025 me datë 04.04.2025 sipas të cilit i është vazhduar afati ankesës së ankueses edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 1148/2025 të datës 20.02.2025 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursin për pozitën Udhëheqës i Divizionit të Transparencës me numër reference RN00016006 të datës 10.12.2024 të Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve; Vendim për themelimin e komisionit të vlerësimit për pranim me numër Nr.06/2023 i datës 14.01.2025 i U.d. Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve; Testi individual i F.L.Q. i datës 24.01.2025; Testi individual i J.A. i datës 24.01.2025; Formular i vlerësimit individual të anëtarit të komisionit për kandidatin në intervistë nga J.B. për J.A. i datës 27.01.2025; Formular i vlerësimit individual të anëtarit të komisionit për kandidatin në intervistë nga J.B. për F.L.Q. i datës 27.01.2025; Formular i vlerësimit individual të anëtarit të komisionit për kandidatin në intervistë nga L.H. për F.L.Q. i datës 27.01.2025; Formular i vlerësimit individual të anëtarit të komisionit për kandidatin në intervistë nga L.H. për J.A. i datës 27.01.2025; Formular i vlerësimit individual të anëtarit të komisionit për kandidatin në intervistë nga V.B. për F.L.Q. i datës 27.01.2025; Formular i vlerësimit individual të anëtarit të komisionit për kandidatin në intervistë nga V.B. për J.A. i datës 27.01.2025; Formular i vlerësimit individual të anëtarit të komisionit për kandidatin në intervistë nga H.R.R. për J.A. i datës 27.01.2025; Formular i vlerësimit individual të anëtarit të komisionit për kandidatin në intervistë nga H.R.R. për F.L.Q. i datës 27.01.2025; Formular i vlerësimit individual të anëtarit të komisionit për kandidatin në intervistë nga M.A. për J.A. i datës 27.01.2025; Formular i vlerësimit individual të anëtarit të komisionit për kandidatin në intervistë nga M.A. për F.L.Q. i datës 27.01.2025; Letërnjoftim i J.A.; E-mail nga J.A. për ankesa.kpmshck@rks-gov.net i datës 20.02.2025; E-mail nga ankesa.kpmshck@rks-gov.net për J.A. i datës 20.02.2025; Kërkesë për përgjigje në ankesë i datës 10.03.2025; Përgjigje në ankesë i datës 19.03.2025; Vendim për shtyrje të afatit i KPMShCK me numër protokolli 2259/2025 i datës 04.04.2025; E-mail nga K.D. për L.H. i datës 10.03.2025; Njoftimi për kandidatin fitues për pozitën Udhëheqës i Divizionit të Transparencës i Njësisë së Burimeve Njerëzore i datës 27.01.2025 i Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve; Njoftim për verifikim paraprak i DBNJ i MFPT i datës 15.01.2025; Lista përfundimtare e vlerësimit të kandidatëve i datës 27.01.2025; Renditja përfundimtare e kandidatëve nga simbnj i datës 27.01.2025; Lista e

aplikantëve nga simbnj; Akt Emërim i J.B. i datës 01.04.2024; Akt Emërim i H.R.R. i datës 13.09.2024; Akt Emërim i L.H. i datës 01.04.2024; Akt Emërim i M.A. i datës 01.04.2024; Akt Emërim i V.B. i datës 01.04.2024; Formular i vlerësimit të përgjithshëm të esesë së kandidatit nga komisioni i pranimit kodi CN1074 i datës 24.01.2025; Formular i vlerësimit të përgjithshëm të esesë së kandidatit nga komisioni i pranimit kodi CN8697 i datës 24.01.2025; Aplikacioni i J.A. i datës 18.12.2024; Vendim nga MASH për J.B. me numër ref.nr.614/506 i datës 09.10.2020; Diplomë nga Universiteti i Tiranës Shqipëri për J.B. me numër nr.7318 i datës 04.07.2003; Certifikatë nga Ikap për J.A. e muajit Qershor 2024; Certifikatë nga BM consulting group për J.A. i datës 13.03.2016; Certifikatë nga Ikap për J.A. e muajit Mars 2015; Certifikatë nga Ikap për J.B.; Certifikatë nga Ikap për J.A. e muajit Qershor 2017; Certifikatë nga Ikap për J.A. e muajit Mars 2011; Certifikatë nga appdec për J.A.; Certifikatë nga Ikap për J.A. e muajit Nëntor 2012; Akt Emërim i J.A. i datës 28.02.2012; Kontratë e marrëdhënies së punës e J.A. i datës 01.01.2010; Kontratë e marrëdhënies së punës e J.A. i datës 01.04.2009; Kontratë e marrëdhënies së punës e J.B. i datës 01.05.2007; Kontratë e marrëdhënies së punës e J.B. i datës 01.01.2007; Kontratë e marrëdhënies së punës e J.B. i datës 04.05.2005; Kontratë e marrëdhënies së punës e J.B. i datës 03.05.2004; Akt Emërim i J.A. i datës 20.02.2013; Akt Emërim i J.A. i datës 04.06.2014; Akt Emërim i J.A. i datës 01.04.2024; Dëshmi për masë disiplinore e J.A. i datës 13.12.2024; Vërtetim nga DBNJ MFPT për J.A. i datës 13.12.2024; Aplikacioni i F.L.Q. i datës 30.12.2024; Diplomë nga Kolegji UBT Prishtinë për F.L.Q. me numër nr.205/45-65 i datës 25.06.2020; Vendim me numër nr.02-65/6 i datës 25.01.2024; Konfirmim nga Drejtori B.N. për F.L.Q. i datës 22.04.2024; Diplomë nga shkolla e lartë e gazetarisë Faik Konica për F.L. i datës 14.06.2003; Diplomë nga Kolegji i Gazetarisë Faik Konica për F.L. me numër nr.226 i datës 20.06.2007; Diplomë për kryerjen e shkollës së mesme profesionale shmt 28 Nëntori Prishtinë për F.L. me numër protokolli 2239 i datës 13.06.2000; Certifikatë nga Rit Kosovo për F.L. i datës 18.12.2018; Certifikatë plotësuese; Korniza kombëtare e kualifikimeve i datës 02.11.2018; Certifikatë nga Ikap për F.L. i datës 21.03.2017; Certifikatë nga Ikap për F.L.; Certifikatë nga EU për F.L. i datës 09.09.2011; Certifikatë nga EU për F.L. e muajit Qershor 2011; Certifikatë nga MEF për F.L.; Certifikatë nga EU për F.L. i datës 10.07.2009; Certifikatë nga Pips për F.L. i datës 16.12.2009; Certifikatë nga Usaid për F.L. e muajit Dhjetor 2018; Certifikatë nga Pai për F.L. e muajit Nëntor 2008; Certifikatë nga eschool për F.L. i datës 22.12.2009; Certifikatë nga UBT për F.L. i datës 28.10.2019; Certifikatë nga UBT për F.L. i datës 28.10.2018; Certifikatë nga European Dde për F.L. i datës 21.06.2019; Certifikatë nga Usaid për F.L. e vitit 2006; Certifikatë nga Ikap për F.L.Q. i datës 20.06.2020; Certifikatë nga European Dde për F.L. i datës 12.12.2019; Certifikatë nga BCC për F.L.Q. i datës 25.01.2021; Certifikatë nga Universiteti Sv. Kirili dhe Metodiji fakulteti i filologjisë Blazhe Konteski Shkup me numër nr.03-1451/2 i datës 06.09.2022 Certifikatë nga Usaid për F.L. i datës 14.03.2006; Certifikatë nga LSE për F.L. i datës 20.05.2005; Certifikatë nga Usaid për F.L. i datës 01.03.2006; Certifikatë nga IPV për F.L. i datës 06.10.2006; Certifikatë nga Usaid për F.L. i datës 11.10.2006; Certifikatë nga Usaid për F.L. i datës 11.04.2006; Certifikatë nga Ikap për F.L. i datës 24.03.2006; Certifikatë nga Usaid për F.L. i datës 07.06.2006; Certifikatë nga Usaid për F.L. i datës 18.07.2006; Certifikatë nga Usaid për F.L. i datës 15.05.2005; Certifikatë nga LSE për F.L. i datës 20.03.2006; Certifikatë nga Usaid për F.L. i datës 15.05.2005; Letër konfirmim për F.L. i datës 24.04.2006; Certifikatë nga MEF për F.L. i datës 11.05.2005; Certifikatë nga Pai për F.L. e muajit Nëntor 2008; Certifikatë nga EU për F.L. i datës 09.09.2011; Certifikatë nga Ikap për F.L. i datës 03.02.2005; Certifikatë nga Elt oxford për F.L. i datës 15.04.2004; Certifikatë nga Osce për F.L. i datës 19.11.2003;

Certifikatë nga Ik për F.L. i datës 16.04.2002; Certifikatë nga Usaid për F.L. i datës 06.02.2007; Certifikatë nga Usaid për F.L. i datës 15.11.2006; Certifikatë nga EU për F.L. e muajit Maj 2011; Certifikatë nga Usaid për F.L. e muajit Janar 2008; Certifikatë nga UBT për F.L. i datës 06.07.2019; Certifikatë nga UBT për F.L.Q. i datës 27.10.2024; Certifikatë nga Ifac për F.L.Q. i datës 28.10.2022; Kontratë Pune e F.L. i datës 07.08.2003; Kontratë Pune e F.L. i datës 13.08.2004; Kontratë Pune e F.L. i datës 12.07.2005; Kontratë Pune e F.L. i datës 04.08.2006; Kontratë Pune e F.L. i datës 01.01.2007; Kontratë Pune e F.L. i datës 11.06.2010; Kontratë Pune e F.L. i datës 04.03.2011; Akt Emërim i F.L. i datës 03.02.2012; Akt Emërim i F.L. i datës 11.03.2014; Letër rekomandim nga H.Sh. për F.L. i datës 15.01.2013; Vendim për pezullimin e marrëdhënies së punës në shërbimin civil i F.L. i datës 03.02.2022; Letër referencë nga Imd për F.L.; Pasqyra e llogarisë së trustit e F.L.Q. i datës 14.07.2003-13.12.2024; Letër rekomandim nga B.V. për F.L.Q.; Vendim i Kuvendit të Kosovës me numër Nr.08-V-138 i datës 06.12.2021; Vërtetim nga Menaxheri i administratës dhe burimeve njerëzore në RTK për F.L.Q. i datës 05.12.2024; Akt Emërim i F.L.Q. i datës 10.12.2024; Vendim i U.d. Sekretarit të Përgjithshëm të MFPT i datës 04.12.2024; Certifikatë nga MEF për F.L. i datës 11.05.2005; Letër rekomandim nga Ë.C. për F.L.Q.; Referencë nga M.Sh. për F.L.Q.; Referencë nga I.I. për F.L. i datës 14.01.2013; Letër rekomandim nga B.V. për F.L.Q.; Letërnjoftim i F.L.Q.; Dëshmi për masë disiplinore nga DBNJ MFPT për F.L.Q. i datës 13.12.2024; Certifikatë mbi dënimet penale e F.L.Q. i datës 30.12.2024; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë 2019 për F.L.; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm i ulët dhe profesional i F.L.Q. i datës 17.01.2022; Kërkesa për punësim e F.L.Q. i datës 30.12.2024; Prova shtesë të datës 24.03.2025; Aplikacioni i S.B.H. i datës 17.12.2024; Diplomë nga Kolegji AAB për S.B.H. me numër nr.795/21 i datës 30.06.2021; Diplomë nga Universiteti AAB për S.B. me numër nr.201/10 i datës 12.07.2010; Diplomë për kryerjen e Gjimnazit Muharrem Bekteshi në Vushtrri për S.B. me numër protokolli 1235 i datës 08.06.1998; Certifikatë nga MASHT për S.B.H.; Certifikatë nga QSHDNJ për S.B. e muajit Qershor 1999; Certifikatë nga International language centre për S.B. i datës 01.12.2001; Certifikatë nga International language centre për S.B. i datës 03.05.2003; Certifikatë nga Kedp për S.B.; Certifikatë nga Isp për S.B. i datës 06.05.2006; Falenderim nga Isp për S.B.; Certifikatë nga Oxford University Press për S.B.H. viti 2011; Certifikatë nga Gei për S.B.H. i datës 16.04.2016; Certifikatë pjesëmarrjeje nga Gulistar për S.B.H. i datës 16.04.2016; Certifikatë nga MASHT për S.B.H. e muajit Qershor 2019; Certifikatë nga Ngo për S.B.H. i datës 15.09.2018; Certifikatë nga Education today për S.B.H. i datës 23.01.2021; Certifikatë nga Qendra Kulturore Filozofike Akropoli i ri për S.B.H. i datës 19.09.2022; Certifikatë nga Isp për S.B. i datës 07.03.2022; Certifikatë nga Education today për S.B.H. i datës 16.02.2019; Licencë e mësimdhënësit për S.B.H.; Certifikatë nga Education today për S.B.H. i datës 05.02.2022; Certifikatë nga Cambridge University press për S.B.H. i datës 30.06.2020; Certifikatë nga mehmet akif college për S.B.H. i datës 20.03.2019; Certifikatë nga Nau për S.B.H.; Certifikatë nga North american university për S.B.H. i datës 24.04.2020; Certifikatë nga North american university për S.B.H. i datës 24.04.2020; Vërtetim nga shkolla fillore Mustafë Venhari Vushtrri për S.B. i datës 06.09.2005; Vërtetim nga shkolla fillore Andon Zako Çajupi Vushtrri për S.B. i datës 06.01.2005; Vërtetim nga Isp për S.B.H. i datës 06.10.2020; Pasqyra e llogarisë së trustit e S.B.H. i datës 01.08.2002-25.09.2024; Kontratë e punës e S.B. i datës 01.04.2009; Kontratë pune për mësimdhënës i S.B. i datës 01.09.2023; Referencë nga A.A. për S.B.H.; Letërnjoftim i S.B.H.; Deklaratë për masë disiplinore e

S.B.H. i datës 29.09.2024; Provë shtesë e datës 27.03.2025; Vendim nga U.d. Sekretari i Përgjithshëm i MFPT për J.B. i datës 08.08.2024;

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa e ankueses, **është e pabazuar, sepse:**

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, më datë 10.12.2024 ka shpallë Konkursin me numër reference RN00016006 për pozitën Udhëheqës i Divizionit Transparencës klasa e pozitës Drejtues i Ulët, ku afati për aplikim ka qenë nga data 11.12.2024 deri më 09.01.2025. Tutje, nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesja me datë 18.12.2024 e cila e ka kaluar fazën e verifikimit paraprak duke plotësuar kriteret e konkursit dhe se i është nënshtruar fazës së testimit me shkrim të mbajtur me datë 24.01.2025, ku në testin me shkrim për pozitën Udhëheqës i Divizionit Transparencës në Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve ka marrë gjithsejtë 50.2 pikë nga rrjedh se ankuesja ka marrë pikët e mjaftueshme për t'iu nënshtruar fazës tjetër të vlerësimit gjegjësisht vlerësimit të intervistës me gojë e cila në intervistë ka marrë gjithsejtë 26.6 pikë. Ndërsa sipas renditjes përfundimtare të kandidatëve del se ankuesja ka marrë pikët totale gjithsejtë 76.8 pikë për pozitën Udhëheqës i Divizionit Transparencës në Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve duke u renditur e dyta.

Ndërsa sipas shkresave të lëndës rezulton në këtë konkurs ka aplikuar kandidatja F.L.Q. me datë 30.12.2024 e cila e ka kaluar fazën e verifikimit paraprak duke plotësuar kriteret e konkursit dhe se i është nënshtruar fazës së testimit me shkrim të mbajtur me datë 24.01.2025, ku në testin me shkrim për pozitën Udhëheqës i Divizionit Transparencës në Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve ka marrë gjithsejtë 56.8 pikë nga rrjedh se ka marrë pikët e mjaftueshme për t'iu nënshtruar fazës tjetër të vlerësimit gjegjësisht vlerësimit të intervistës me gojë e cila në intervistë ka marrë gjithsejtë 28.6 pikë. Ndërsa sipas renditjes përfundimtare të kandidatëve del se ka marrë pikët totale gjithsejtë 85.4 pikë për pozitën Udhëheqës i Divizionit Transparencës në Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve duke u renditur e para.

Ndërsa Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve me datë 27.01.2025 ka publikuar Njoftimin për kandidatin fitues për pozitën Udhëheqës i Divizionit Transparencës në Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve për kandidaten F.L.Q. me gjithsejtë 85.4 pikë.

Ankuesja ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimin ankimor kundër njoftimit për kandidatin fitues për pozitën Udhëheqës i Divizionit Transparencës të Njesisë së Burimeve Njerëzore të datës 27.01.2025 të Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve, për shkak të njëanshmërisë nga ana e komisionit të pranimi, ushtrimit të ndikimit ndërhyrjes ndaj një anëtareje të komisionit të pranimi në vlerësimin e esesë, shkeljes së paragrafit 10.3 të nenit 10, paragrafit 3 të nenit 11 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për procedurën e pranimi në shërbimin civil e njëjta dyshon që i është bërë e padrejtë dhe janë shkelur rregullat e rregullores përkatëse nga anëtarët e komisionit konkretisht kryesuesi, dhe se komisioni e ka vlerësuar me pikët maksimale

kandidaten fituese ndërsa mua me pikët minimale, kërkon të anulohet konkursi për pozitën Udhëheqës i Divizionit Transparencës dhe të rishpallet për të njëjtën pozitë.

Në kuptim të dispozitave të nenit 89 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe në kontest të shqyrtimit të pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit ka analizuar konkursin me numër të referencës RN00016006 për pozitën Udhëheqës i Divizionit Transparencës në Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve, dhe si rrjedhojë konstatoi se si kritere të përgjithshme formale për pozitën përkatëse të punës kanë qenë: **Arsimimi i kërkuar:** Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor) në Gazetari/Shkenca komunikimi, Gjuhë dhe Letërsi, Marrëdhënie me Publikun, Marketing. **Përvoja e punës e kërkuar:** Së paku tri (3) vite përvojë pune profesionale.

Kolegji i Këshillit, në përmbushje të mandatit të tij kushtetues dhe ligjor për sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve në shërbimin civil, fillimisht ka analizuar aktin e themelimit të Komisionit të pranimit, gjegjësisht vendimin me numër Nr.06/2025 të datës 14.01.2025 nga analizimi i të cilit ka gjetur se Komisioni i pranimit për pozitën Udhëheqës i Divizionit Transparencës është në përbërje prej pesë (5) anëtarëve, kryesues J.B. në pozitën e punës ushtrues i detyrës së Udhëheqësit të Divizionit për Vlerësimin e Projekteve të Partneritetit Publiko Privat në Departamentin për Partneritetet Publiko Private, anëtarja H.R.R., në pozitën e punës Udhëheqëse e Divizionit për Menaxhimin e Aplikacioneve në Departamentin për Menaxhimin e Sistemeve të TI-së, anëtarja V.B. në pozitën e punës Zyrtar i Lart për Komunikim Publik në Divizionin e Transparencës, anëtarja M.A. në pozitën e punës Udhëheqës i Divizionit Buxhetit Qendror në Departamentin e Buxhetit si dhe anëtarja L.H. në pozitën e punës Zyrtar i Personelit në Divizionin e Burimeve Njerëzore. Kolegji i Këshillit konstaton se pozita Udhëheqës i Divizionit Transparencës, klasifikohet si Kategoria e ulët drejtuese që përfshin pozitën e udhëheqëses/it të divizionit dhe pozitat e barasvlershme me të siç përcaktohet me nenin 38 paragrafi 2 nën paragrafi 2.3 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, andaj edhe Komisioni i pranimit duhet të jetë në përbërje siç kërkohet me nenin 45 paragrafi 1 dhe 2 të këtij ligji ku përcaktohet se: *1. Vlerësimi profesional i kandidateve/ëve për emërimin në një pozitë të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese në administratën shtetërore bëhet nga komisioni i pranimit. 2. Komisioni i pranimit për pozita të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese, ka pesë (5) anëtare/ë, në këtë përbërje: 2.1. tre (3) nëpunëse/ës civil ekzistues të kategorisë së njëjtë apo më të lartë; 2.2. një (1) nëpunëse/ës civil nga njësia përgjegjëse; dhe 2.3. një (1) nëpunëse/ës civil me njohuri në fushën e pozitës së lirë..., dhe si rrjedhojë bazuar në kuadrin përkatës ligjor, si dhe shqyrtimi dhe analizimi i provave të lëndës, Kolegji ka gjetur se përbërja e komisionit të pranimit në procedurën përkatëse të rekrutimit ka qenë në pajtim me kërkesat ligjore.*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave fillimisht ka konstatuar se kriteret e konkursit për pozitën Udhëheqës i Divizionit Transparencës në Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve kanë qenë në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil. Po ashtu Kolegji i Këshillit ka analizuar dosjen e kandidate fituese F.L.Q. dhe ka konstatuar se e njëjta i ka plotësuar kriteret lidhur me arsimimin e kërkuar si dhe përvojën e punës ashtu siç ka qenë e përcaktuar me konkurs për pozitën e lartcekur.

Referuar kuadrit ligjorë si më lartë, Kolegji i Këshillit ka shqyrtuar dosjen e kandidatës F.L.Q, të shpallur fituese dhe si rrjedhojë ka gjetur se e njëjta posedon Diplomën e studimeve themelore universitare nga Kolegji i Gazetarisë Faik Konica Dega e Gazetarisë me titull Baçelor i Gazetarisë me numër nr.226 të datës 20.06.2007, Diplomën e studimeve postdiplomike Master nga Kolegji UBT në programin Media dhe Komunikim me titull Master i arteve në Media dhe Komunikim me numër nr.205/45-65 të datës 25.06.2020 me përvojë punë si ne vijim; sipas Kontratës së punës të lëshuar nga Ministria për Ekonomi dhe Financa në pozitën e punës Zyrtare për marrëdhënie me publikun nga data 01.01.2007 deri 31.12.2009, sipas Kontratës së punës të lëshuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave në pozitën e punës Zyrtare për marrëdhënie me publikun nga data 01.01.2010 deri 31.12.2010, sipas Kontratës së punës të lëshuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave në pozitën e punës Zyrtare për marrëdhënie me publikun nga data 01.01.2011 deri 31.12.2013, sipas Akt Emërimit të lëshuar nga Ministria e Financave në pozitën Zyrtare për marrëdhënie me publikun të datës 01.02.2012, sipas Akt Emërimit të lëshuar nga Ministria e Financave në pozitën Zyrtare e Lartë për marrëdhënie me publikun të datës 11.03.2014, sipas vërtetimit të lëshuar nga Menaxheri i Administratës dhe Burimeve Njerëzore në RTK përmes të cilit vërtetohet se ka qenë anëtare e bordit të RTK-së nga data 06.12.2021 deri 06.12.2024 me mandat tre vjeçar.

Ndërsa, në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore, Kolegji iu referuar dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrarët Publikë, me theks të veçantë: Nenit 39 paragrafi 1: *1. Pranimi në shërbimin civil bëhet në të gjitha kategoritë e shërbimit civil, nëpërmjet një procedure rekrutuese të hapur dhe publike, përveç kur parashikohet ndryshe me këtë ligj.* Nenit 44: *“ 1. Pranimi në pozitë të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese bëhet me konkurs të hapur dhe publik të organizuar për çdo pozitë të lirë. 2. Procedura e rekrutimit organizohet nga njësia përgjegjëse për institucionet e administratës shtetërore dhe nga NjMBNj për çdo institucion tjetër shtetëror. 3. Shpallja e procedurës së rekrutimit bëhet nga njësia përgjegjëse, në SIMBNj-së, në ueb faqen e institucionit përkatës, si dhe me mjete të tjera të përshatshme të informimit. 4. Pranimi i aplikacioneve bëhet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e shpalljes së procedurës së rekrutimit. 5. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 5.1. verifikimi paraprak, përmes së cilit verifikohet nëse kandidatet/ët plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të posaçme, sipas shpalljes së konkursit; dhe 5.2. vlerësimi profesional, që përfshin vlerësimin e njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidateve/ëve. 6. Verifikimi paraprak kryhet nga njësia përgjegjëse, ndërsa vlerësimi profesional kryhet nga komisioni i pranimit për pozita të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese. 7. Vlerësimi profesional i kandidateve/ëve përfshin testim me shkrim në formë elektronike ku sigurohet anonimiteti i konkurrentëve, si dhe intervistë me gojë. 8. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidateve është njëqind (100) pikë. 9. Në përfundim të vlerësimit, kandidatja/i i vlerësuar me më së shumti pikë, por jo më pak se shtatë dhjetë për qind (70 %) të pikëve totale të vlerësimit, konsiderohet kandidat fitues. Të gjithë kandidatet/ët njoftohen individualisht me rezultatet e procesit të rekrutimit. Lista e kandidateve/ëve që kanë kaluar pragun prej shtatëdhjetë për qind (70%) të pikëve totale publikohet në SIMBNj-së, si dhe në ueb faqen e institucionit përkatës. 10. Kandidatet/ët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK sipas afatit të përcaktuar në ligjin përkatës për procedurën administrative. Nenit 45 paragrafi : 1. Vlerësimi profesional i kandidateve/ëve për emërimin në një pozitë të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese në administratën shtetërore bëhet nga komisioni i pranimit. 2. Komisioni i pranimit për pozita*

të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese, ka pesë (5) anëtare/ë, në këtë përbërje: 2.1. tre (3) nëpunëse/ës civil ekzistues të kategorisë së njëjtë apo më të lartë; 2.2. një (1) nëpunëse/ës civil nga njësia përgjegjëse; dhe 2.3. një (1) nëpunëse/ës civil me njohuri në fushën e pozitës së lirë.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit për vendosje të drejtë dhe meritore lidhur me çështjen administrative në procedurë ankimore, mori parasysh edhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, me konkret: **Nenin 7: Verifikimi paraprak 1.** Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidatët për pranim në shërbimin civil plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit. 2. Verifikimi paraprak kryhet nga NjMBNj, më së largu pesëmbëdhjetë (15) ditë pas kalimit të afatit për pranimin e aplikacioneve, në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikimit. 3. NjMBNj publikon në SIMBNj dhe uebfaqen e institucionit listën e kandidatëve të cilët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato specifike. 4. NjMBNj njofton kandidatët që nuk plotësojnë kushtet për rekrutim, duke përfshirë të gjitha kriteret dhe/ose dëshmitë e pa përmbushura jo më vonë se tre (3) ditë kalendarike nga data e publikimit të rezultateve. **Nenin 8:** Vlerësimi profesional Faza e vlerësimit profesional përbëhet nga testi me shkrim dhe intervista dhe zhvillohet nga Komisioni i Pranimit me mbështetjen e NjMBNj. **Nenin 9** Vlerësimi nëpërmjet testimit me shkrim 1. Vlerësimi nëpërmjet testimit me shkrim është hapi i parë i procesit të vlerësimit profesional të kandidatëve pas verifikimit paraprak, dhe duhet të realizohet më së largu 15 ditë pas publikimit të listës së kandidatëve që kanë kaluar verifikimin paraprak. 2. Në testimin me shkrim, kandidatët vlerësohen për njohuritë, aftësitë dhe cilësitë kryesore të domosdoshme, të kërkuara për pozitën apo grupin e pozitës përkatëse. 3. Vlerësimi maksimal i mundshëm për testimin me shkrim është deri në shtatëdhjetë (70) pikë. 4. Testimin me shkrim e kalojnë vetëm kandidatët që marrin të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim. 5. Komisioni i Pranimit në përbërje të plotë është i obliguar ditën e zhvillimit të testimit me shkrim të përzgjedhë nga bankat e pyetjeve që disponon Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, pyetjet e testit me shkrim të modelit zgjedhje e shumëfishtë me një përgjigje të saktë, si dhe një ese me shkrim, duke marrë parasysh fushat e njohurive dhe aftësive të përcaktuara në shpalljen për rekrutim. 6. Testi me shkrim përmban gjithsej njëzet e pesë (25) pyetje dhe një (1) ese të shkurtër. Secila përgjigje e saktë vlerësohet me dy (2) pikë, ndërsa eseja mund të vlerësohet me më së shumti njëzetë (20) pikë. 7. Kohëzgjatja e testimit me shkrim është jo më shumë se nëntëdhjetë (90) minuta. 8. Anëtarët e Komisionit të Pranimit, vlerësojnë testin me shkrim në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, më së voni në afat prej dhjetë (10) ditësh nga dita e përfundimit të tij. Pyetjet me zgjedhje të shumëfishtë vlerësohen nga sistemi në mënyrë elektronike, ndërsa eseja vlerësohet nga Komisioni i Pranimit. 9. Eseja vlerësohet nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Pranimit në mënyrë individuale, të cilët e nënshkruajnë formularin e vlerësimit dhe vendosin pikët në SIMBNj. Mbledhja e pikëve të secilit anëtar të Komisionit, nxjerr mesataren e vlerësimit përfundimtar për ese nga ana e Komisionit, për një kandidat të caktuar. Shuma e pikëve të vlerësuara nga sistemi dhe pikëve të esesë, përbën vlerësimin përfundimtar të testimit me shkrim. 10. Pas vlerësimit të testimit me shkrim, NjMBNj sipas rekomandimeve të Komisionit të Pranimit e përpilon listën e kandidatëve që e kanë kaluar testimin me shkrim. 11. Lista sipas paragrafit 10 të këtij neni bëhet publike nga NjMBNj në SIMBNj, faqen e institucionit si dhe me mjete të tjera të përshtatshme të informimit. **Nenin 10:** Vlerësimi nëpërmjet intervistës 1. Pas vlerësimit të testimit me shkrim, vlerësimi i kandidatëve vazhdon me intervistën, e cila realizohet në mënyrë verbale e cila duhet të përfundojë më së voni pesëmbëdhjetë (15) ditë pas

publikimit të listës së kandidatëve që kanë kaluar testimin me shkrim. 2. Vetëm kandidatët që kanë marrë të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim, kanë të drejtë të marrin pjesë në intervistë. 3. Komisioni i Pranimi njofton kandidatët që kanë kaluar me sukses testimin me shkrim lidhur me ditën, kohën dhe vendin e mbajtjes së intervistës. 4. Në intervistë, vlerësohen njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara që nuk mund të vlerësohen nëpërmjet testimit me shkrim. 5. Intervista zhvillohet nga Komisioni i Pranimi i cili përgatit apo përzgjedh nga bankat e pyetjeve grup pyetjesh të njëjta për të gjithë kandidatët për intervistën. Këto pyetje duhet të përgatiten/përzgjedhin në ditën e zhvillimit të intervistës, përveç pyetjes për prezantim nga paragrafi 7 i këtij neni që përzgjidhet dhe u dërgohet kandidatëve së bashku me njoftimin për orarin e intervistës. 6. Intervista në kategorinë profesionale, të ulët dhe të mesme drejtuese, përmban pesë (5) pyetje, ku secila vlerësohet me më së shumti katër (4) pikë. Përveç pyetjeve, anëtarët e Komisionit të Pranimi mund të parashtrojnë edhe nënpyetje për kandidatin me qëllim të vlerësimit më të saktë të kandidatit lidhur me pyetjen kryesore. 7. Intervista për kandidatët për pozitën e kategorisë së lartë drejtuese bazohet në kompetencë dhe përmban pesë (5) pyetje të cilat vlerësohen me më së shumti tre (3) pikë, si dhe një (1) pyetje për prezantim e cila vlerësohet me më së shumti 5 pikë. 8. Secili nga anëtarët e Komisionit të Pranimi bën vlerësimin e detajuar për secilën pyetje. 9. Në intervistë kandidati mund të merr më së shumti tridhjetë (30) pikë, ku prej tyre dhjetë (10) pikë janë për jetëshkrimin (CV). 10. Vlerësimi maksimal për jetëshkrimin ndahet si vijon: 10.1. deri në tre (3) pikë për arsimimin; 10.2. deri në katër (4) pikë për përvojën relevante në punë; dhe 10.3. deri në tre (3) pikë për trajnimet relevante. 11. Vlerësimi përfundimtar i intervistës për një kandidat është mesatarja aritmetike e vlerësimeve të të gjithë anëtarëve. **Nenin 11:** Shpallja e rezultatit përfundimtar 1. Vlerësimi përfundimtar i kandidatit përfshin shumën e pikëve të përfituara në secilin hap të vlerësimit. 2. Pas përfundimit të intervistës, Komisioni i Pranimi përgatit listën përfundimtare të kandidatëve që kanë kaluar pragun prej 70% të pikëve totale që e përcjell te NjMBNj, emrin dhe mbiemrin e kandidatit fitues, si dhe pikët e arritura në testin me shkrim, intervistën dhe pikët e përgjithshme për secilin kandidat. Andaj si rrjedhojë e kësaj pretendimet ankimore të ankueses janë të pabazuara.

Tutje, nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se ankuesja në fazën e testimit me shkrim ka arritur t'i mbledhë gjithsejtë 50.2 pikë për pozitën e punës Udhëheqës i Divizionit Transparencës në Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve nga rrjedh se ankuesja ka marrë pikët e mjaftueshme për t'iu nënshtruar fazës tjetër të vlerësimit gjegjësisht vlerësimit të intervistës me gojë e cila në intervistë ka marrë gjithsejtë 26.6 pikë në total gjithsejtë 76.8 pikë. Ndërsa sipas shkresave të lëndës rezulton se kandidatja fituese F.L.Q. në fazën e testimit me shkrim ka arritur t'i mbledhë gjithsejtë 56.8 pikë për pozitën e punës Udhëheqës i Divizionit Transparencës në Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve ndërsa në intervistë ka marrë gjithsejtë 28.6 pikë në total gjithsejtë 85.4 pikë. Si rrjedhojë e njëjta ka fituar të drejtën për emërim në shërbimin civil, në pajtueshmëri me dispozitat e nenit 11 të Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Andaj, bazuar në rrethanat dhe konstatimet si më lartë, Kolegji i Këshillit konstaton se Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve me rastin e shpalljes së Njoftimit për kandidatin fitues të datës 27.01.2025 për pozitën e punës Udhëheqës i Divizionit Transparencës në Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve, sipas konkursit me numër reference RN00016006 ka zbatuar drejtë ligjin material, duke vepruar kështu në pajtim me dispozitat e

Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, Rregulloren Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren (QRK) Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të punës në Shërbimin Civil, ndërsa nga provat e lëndës, Kolegji nuk ka evidentuar ndonjë shkelje procedurale apo materiale e cila do të cenonte të drejtën e ankueses, sepse mbi bazë të provave materiale të lëndës, konstatohet fakti se vlerësimi i testit me shkrim respektivisht eses dhe intervistës me gojë është bërë në mënyrë krejtësisht ligjore dhe ankuesja nuk mund të argumentoj faktin ndryshe, kështu që neni 11 paragrafi 3 i Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nuk parasheh publikim të vlerësimit individual të secilit anëtar të komisionit të pranimit, kështu që bazë në provat e lëndës, ankuesja pretendimet ankimore nuk i ka mbështetur me prova materiale.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nënin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.344/2025

Çlirim Zeka

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses J.A.;
- Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve (Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore); si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.